

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK


Për Programin e studimit Master Profesional në Financë-Bankë

Ofruar nga Universiteti “Epoka”

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Hysen Çela

Prof. Dr. Fatmir Memaj

Handwritten signatures in blue ink, corresponding to the names of the external evaluators listed to the left.


(Gusht/2018)

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master profesional në Financë – Bankë, ofruar nga Universiteti “Epoka”

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti “Epoka”
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative
3	Urdhëri i licensimit të programit	VKM Nr 908, datë 26.08.2009
4	Urdhri/VKM i akreditimit të parë	UMASH Nr 286, datë 06.07.2012
5	Titulli i programit të studimit:	Master profesional në “Financë - Bankë”
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha angleze
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	Jo
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	–
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	–
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	Niveli 7
16	Numri i studentëve	18 studentë
	etj	

Shënim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL



HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Master Profesional në Financë-Bankë

Programi Master Profesional në Financë – bankë është licensuar me VKM Nr 908, datë 26.08.2009 “Për hapjen e programeve të reja të studimit, pranë Shkollës së Lartë, Private “Epoka”, Tiranë, si program i ciklit të tretë Master i Nivelit të Dytë me plotësimin e 60 krediteve. Me Urdhër të MASH Nr 248, datë 06.05.2010 “Për lejimin për ushtrimin e veprimtarisë akademike në përputhje me licensën e dhënë për hapjen e programeve të reja të studimit, Shkollës së Lartë Private “Epoka”, Tiranë” është lejuar ushtrimi i veprimtarisë akademike për këtë program studimi. Mbështetur në shkresën e MASH nr 527/1, datë 31.05.2011 me lëndë “Kthim përgjigje”, është bërë përshtatja e programit të ciklit të tretë, me kohëzgjatje normale 1 vit akademik që realizohet me 60 kredite (ECTS) në “Financë – Bankë” në program studimi në përfundim të të cilës lëshohet diplomë “Master Profesional”. Me Vendim të Këshillit të Akreditimit (VKA) Nr 339, datë 08.06.2012 është akredituar programi Master profesional në “Financë – Bankë” me rekomandime. Me Urdhër të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (UMASH) Nr 286, datë 06.07.2012 “Për akreditimin e disa programeve të studimit të ciklit të dytë të Shkollës së Lartë Private “Epoka” është akredituar programi në përputhje me VKA Nr 339, datë 08.06.2012.

Në vitin 2012, bazuar në VKM Nr. 553, datë 22.08.2012, është miratuar ndryshimi i statusit të institucionit privat të arsimit të lartë “Epoka” nga Shkollë e Lartë Private “Epoka” në Universiteti Privat “Epoka”. Me Urdhër të MASH Nr. 146, datë 31.03.2017 “Për miratimin e statutit” emri i Institucionit është Universiteti “EPOKA”.

Programi i studimit Master Profesional në “Financë – Bankë” ofrohet në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative, në Departamentin Financë – Bankë. Në këtë Departament, personeli akademik në kohë të plotë, për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 7 (PAE) nga të cilët 1 Prof As; 3 Dr dhe 3 Msc. Gjithashtu në këtë Departament pjesë përbërëse e tij janë edhe 4 personel akademik me kohë të pjesshme (PAK) nga të cilët 1 Prof As dhe 3 Dr.

Stafi i anagazhuar në këtë program studimi për vitin akademik 2017-2018 përbëhet nga 11 pedagogë PAE nga të cilët 1 Prof. Dr; 3 Prof. As, 6 Dr dhe 1 Asistent Prof Dr. I gjithë programi i studimit mbulohet nga Staf akademik me kohë të plotë. Numri i studentëve për këtë vit akademik të rregjistruar për herë të parë është 18 studentë.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:

1. Prof Dr. Hysen ÇELA.
2. Prof.Dr. Fatmir MEMAJ

Menaxhere teknike e ndjekjes së procedurës së këtij programi studimi është Specialistja e ASCAL, Znj Suela Kromidha

Me datë 24.07.2018 dërgohet në Institucion Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm i hartuar nga ekspertët e vlerësimit. Më datë 27.07.2018 Institucioni sjell në ASCAL po nëpërmjet sistemit përgjigje në lidhje me Draft – RVJ. Institucioni shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti dhe në të njëjtën kohë angazhohet në vlerësimin dhe marrjen në konsideratë të rekomandimeve të bëra, duke qenë dhe në përputhje me planin strategjik të institucionit dhe departamentit, në mënyrë që të përmirësojë më tej cilësinë e programit të studimit “Master Profesional” në “Financë-Bankë”.

Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Shënim i GVJ: Theksojmë se Raporti i vlerësimit të jashtëm si për programin MP dhe për MSc me të njëjtin emërtim “Financë – Bankë” është vlerësuar nga i njëjti Grup i Vlerësimit të Jashtëm. Departamenti bazë që i mbulon këto dy Mastera është Departamenti Financë Bankë. Për rrjedhojë disa paragrafe të vlerësimit janë të

njejta në të dy Raportet, mbështetur kjo edhe në takimet në Institucion të cilat u realizuan duke marrë të dhëna për të dy programet (si p.sh. rubrika 6 NJSBC, apo 11 Bashkëpunimi kombëtar, pjesë të rubrikës 1 dhe 2,etj)

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

1. Të përmirësohen programet aktuale të studimeve duke shtuar si lëndë të detyrueshme lëndët e formimit bazë ekonomik dhe lëndët që lidhen me raportimin financiar të besueshëm dhe me rolin e auditimit.
2. Rritja e numrit të studentëve, duhet të jetë gjithashtu edhe një nga pikësynimet kryesore të Universitetit. Të realizohet një fushatë sensibilizimi më e gjërë në shkollat e mesme, duke zhvilluar aktivitete të ndryshme me këta nxënës në ambientet e Institucionit dhe duke I treguar çka ai ofron.
3. Të përmirësohet treguesit e të ardhurave për të rritur mbështetjen në burimet e veta dhe pakësuar varësin nga burimet jashtë universitetit.
4. Të përpqiet që të ofrojë programe studimi në Master më të specifikuar të ndryshme nga ato që ofron i gjithë tregu I arsimit të lartë.
5. Të hartohen strategji afatmesme dhe afatgjatë të universitetit, të specifikuar qartë, të cilat do të shërbenin për një vision më të gjerë të punës së tyre.
6. Të rritet mbështetja financiare për stafin e ri për të ndjekur kualifikime afatgjata jashtë shtetit në fushën përkatëse të studimit, pasi me të rritet cilësia e aktivitetit mësimdhënës.
7. Të sigurohet që studentët e këtij programi studimi duhet të japin në përfundim edhe provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

1. Për rekomandimin (1): Nga institucioni janë shtuar lëndë me detyrim dhe me zgjedhje që ndihmojnë aktivitetin në tregun bankar. Në programin e Masterit Profesional në Financë-Bankë është futur si lëndë me detyrim lënda e metodave kërkimore.
2. Për rekomandimin (2): Institucioni gjatë tre viteve të fundit ka bërë të mundur rritjen në mënyrë të ndjeshme të numrit të studentëve.
3. Për rekomandimin (3): institucioni ka punuar në drejtim të përmirësimit të treguesve të të ardhurave, duke zvogëluar ndjeshëm numrin e pedagogëve me kohë të pjesshme (të jashtëm). Aktualisht në këtë program nuk ka asnjë pedagog me kohë të pjeseshme, kështu që mesimdhënia në këtë program te mbështetet në personelin e brendshëm.
4. Për rekomandimin (4): Institucioni ka ofruar për studentët studimet Master në Menaxhimin e Huave, program që paraqitet konkurrues në treg, bazuar në planin strategjik të departamentit 2017-2022
5. Për rekomandimin (5): Institucioni ka hartuar strategji afatmesme dhe afatgjatë të universitetit, të cilat janë perfshire në Planin Strategjik 2013-2017

6. Për rekomandimin (6): Përveç alokimit të mbështetjes financiare për rritjen e kualifikimeve për mësimdhënien dhe kërkimin shkencor, Universiteti mbështet financiarisht personelin e ri për kualifikimin e tij te mëtejshëm afatgjatë.
7. Për rekomandimin (7): Institucioni ka përmbushur rekomandimin duke përfshirë në kriteret e pranimit të Universitetit "EPOKA", kërkesën që studentët duhet të dorëzojnë certifikatë të gjuhës angleze që njihet ndërkombëtarisht, minimalisht e nivelit B2, me qëllim që të regjistrohen në programin e studimeve për çdo nivel të studimeve.

Rekomandimet e mëparëshme janë marrë plotësisht në konsideratë.

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi Master Profesional në Financë-Bankë, i ofruar nga Departamenti i Financë-Bankës është pjesë integrale e studimeve në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative në Universitetin "EPOKA". Departamenti është njësi bazë kërkimore në disiplinën e finances dhe fusha të tjera të lidhura me të. Ai koordinon dhe menaxhon veprimtaritë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor, nxit lirinë akademike të personelit dhe të drejtën për përdorimin e burimeve materiale dhe financiare në dispozicion të tij. Nëpërmjet studimeve Master, studentëve ju garantohen mundësi për të zhvilluar karrierën profesionale dhe akademike, posaçërisht në sektorin financiar dhe atë bankar.

Sipas RVB por edhe takimit me Përgjegjësën e Departamentit Prof As Ugur Ergun, Departamenti ka për mision të ju përgjigjet nevojave për profesionistë të kualifikuar në sektorin Financë-Bankë dhe të përgatisë individë të kualifikuar për të gjithë sektorët në vend, përfshirë biznesin privat, organizmat publike dhe shtetërore, si edhe sektorin e organizatave jofitimprurëse.

Në lëndët e programit Master përfshihen disiplina teorike dhe teknike, të cilat i pajisin studentët me dije të avancuara profesionale.

Në 2 semestrat e këtij programi, studentët njihen me koncepte të avancuara teorike dhe praktike në lidhje me zhvillimet më të fundit strategjike, menaxheriale dhe industriale në tregjet financiare vendore dhe globale, me theks të veçantë të rastet studimore dhe problematikat bashkëkohore.

Në mbyllje të programit përmes punimit të kursit, studentëve iu jepet orientime që ata të përmirësojnë aftësitë kërkimore dhe të kryejnë vete me sukses kërkimin.

Mbështetur në RVB por edhe në Rregulloren e programit të studimit, disa nga objektivat kryesore të këtij programi të cilat do ti veçonim janë:

- Përfitimi i koncepteve të avancuara që lidhen me fuhat e financës dhe bankave si dhe përdorimi efikas i tyre
- Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që ti përshtaten tregut të punës
- Integrimi i teorikës, praktikave dhe politikave të ndryshme, në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën si funksionojnë politikat financiare dhe bankare
- etj

Në programin Master profesional, studentët familjarizohen me çështje të ndryshme të financave si edhe zhvillojnë aftësitë e shkrimit dhe komunikimit.

Pedagogët realizojnë një mësimdhënie efektive me praktikë të bollshme, bazuar në realitetin vendas dhe sisteme të tjera efektive në botë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>GVJ mendon se programi Master Profesional në Financë-Bankë është hartuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> në përputhje të plotë me qëllimin dhe misionin e institucionit - një <i>institucion mësimdhënës dhe kërkimor novator, në shërbim të vlerave themelore njerëzore, për përgatitjen e individëve të kualifikuar, kompetentë, me shpirt hulumtues, të cilët zotërojnë etikë profesionale.</i> bazuar në nevojat e tregut të punës, specifkisht sektori bankar e financiar. Ai është orientuar në Strategjinë kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, të publikuar nga Shoqata e Bankave (2018) <p>Në programin e studimit mbahen parasysh prirjet e zhvillimit ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës (Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020). Gjithashtu, programi reflekton vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Qëllimi i programit Master Profesional në Financë-Bankë përputhet me misionin e përgjithshëm të Universitetit "EPOKA", është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe merr parasysh edhe zhvillimet në fushën e teknologjisë së informacionit. Programi është në pajtim me objektivat e duke pasur parasysh se cilësia e mësimdhënies është në fazat e para në Shqipëri, institucioni ka objektiva të qartë afatmesëm dhe afatgjatë në strategjinë e zhvillimit të institucionit</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me kriteret e përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe me Kartën e Bolonjës. Emërtimi i programit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe në përputhje me nivelin 7 të Kuadrit Shqiptar të Kualifikimit</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>Universiteti ka hartuar planin strategjik për periudhën 2013-2017, në të cilin janë parashikuar drejtimet kryesore të përmirësimit të programeve të studimeve, të mësimdhënies dhe nxënies. Plani strategjik për vitin 2018-2023 ishte në Draft dhe drejt përfundimit.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<p>1. Masteri Profesional Finance Bnake që ofrohet nga Universiteti Epoka është në përputhje me misionin, qëllimin dhe strategjinë zhvillimore të Universitetit.</p>	

2. Programi Master Profesional i përgjigjet nevojave të tregut të punës dhe prirjeve të zhvillimit të tregut financiar në vendin tonë.
 3. Studentët e përgatitur sipas këtij programi kanë mundësi punësimi në tregun vendas dhe atë të huaj
- Standardi përmbushet.**

2. Struktura akademike e Fakultetit (departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Programi i studimit Master profesional në "Financë – Bankë" ofrohet nga Departamenti i Financë – bankës, në Fakultetin e Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Gjatë takimit me drejtuesit e këtij Fakulteti Prof. As Salih Ozcan dhe Përgjegjës të Departamentit Prof As Ugur Ergun, GVJ-së ju komunikua se Departamenti është përgjegjës për realizimin cilësor të këtij programi studimi. Të gjitha diskutimet në lidhje me programin e studimit realizohen në Këshillin Shkencor të Departamentit. Më tej këto diskutime paraqiten edhe në Dekanat. Ka çështje që lidhen kryesisht me sigurimin e cilësisë të cilat merren në Departament dhe më pas njoftohet Dekanati për transparencë, por ka edhe vendime të cilat merren në Dekanat por që pjesëmarrës në këto vendime janë edhe përfaqësues nga Departamenti.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura akademike e Fakultetit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative, është një nga tre njësitë kryesore në Universitetin "EPOKA". Ai koordinon mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe zhvillimin kulturor. Fakulteti ofron programe Bachelor dhe Master, si edhe PhD, në fund të të cilave jepet diploma përkatëse sipas emërimit..

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative përbëhet nga:

- Departamenti i Financë-Bankës;
- Departamenti i Administrim Biznesit;
- Departamenti i Ekonomiksit.

Të dhënat lidhur me numrin e personelit akademik efektiv dhe të atij me kontratë, sipas departamenteve janë dhënë në Tabelën 1 në Aneksë.

Programi ofrohet në Departamentin e Financë Bankës. Dekanati është organ kolegjal vendimmarrës që programon dhe organizon mësimdhënien dhe kërkimin shkencor të Fakultetit bazuar në propozimet e departamenteve.

Dekanati përbëhet nga Dekani që e kryeson dekanatin, Zv. Dekani, përgjegjës të departamenteve, përgjegjës të qendrave të kërkimit shkencor dhe administratori i njësisë kryesore.

Të dhëna për Stafin akademik të Departamentit përgjegjës

Departamenti Finance Banke ka në total një personel prej 15 vetash, të ndarë në:

- Personel akademik me kohë të plotë (PAE) 7 vetë

- Personel akademik me kohë të pjesshme (PAK) 4 vetë
- Personel administrativ 4 vetë

Në Departamentin e Financë Bankës për vitin akademik 2017-2018 që mbështet programin e studimit Master profesional janë përfshirë:

(a) Personel me kohë të plotë:

- Prof. Asoc. Dr. U. Ergun - Përgjegjës Departamenti
- Dr Ch. Balomenou - Pedagog.
- Dr P. K. Kabeya - Pedagog.
- Dr N. Mera - Pedagog.
- M.Sc A. Gerdec - As. Profesor.
- Msc E. Imeraj - As. Profesor.
- Msc E. Gjoci - As. Profesor

(b) Personel me kontrate

- Dr A. Zibri - Alpha Bank
- Prof. Dr. Asoc O. Dhuci - Alpha Bank
- Dr M. Kalia - . Ministria e Financave
- Dr K. Hykaj - Ministria e Ekonomisë e Financave

Referuar të dhënave të paraqitura nga Institucioni në Dosjen e vetëvlerësimit (DVV), stafi akademik i departamentit ndër vite paraqitet si më poshtë”

2016-2017 – Departamenti përbëhej nga 8 PAE (1 Prof As; 2 Dr; 4 Msc dhe 1 Bsc)

10 PAK (1 Prof. As; 4 Dr; 5 Msc

2015-2016 - Departamenti përbëhej nga 9 PAE (1 Prof. As; 2 Dr; 4 Msc; 2 Bsc)

10 PAK (1 Prof. As; 3 Dr; 6 Msc)

2014-2015 - Departamenti përbëhej nga 9 PAE (3 Dr; 4 Msc; 2 Bsc)

11 PAK (1 Prof. As; 4 Dr; 6 Msc)

2013-2014 - Departamenti përbëhej nga 7 PAE (1 Prof. Dr; 3 Dr; 3 Msc)

6 PAK (2 Dr; 4 Msc)

2012-2013 - Departamenti përbëhej nga 9 PAE (1 Prof. Dr; 2 Dr; 4 Msc; 2 Bsc)

3 PAK (3 Msc)

Më shumë informacione lidhur me numrin e personelit akademik në Departamentin Financë bankë dhe listën emërore sipas viteve, jepen në tabelat në Anekse, nr.2; nr 3; nr. 4; 4/1;

Siç edhe paraqitet, GVJ konstaton se Departamenti në përbërje të tij ka patur numrin e nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Vlerësimi sipas standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	

<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore “Doktor”.</p>	<p>Universiteti Epoka ka në përbërje të tij 3 Fakultete në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe përmbush misionin e tij të deklaruar.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Administrative është i organizuar në 3 (tre) departamente: Administrim Biznesi; Ekonomiks; Financë-Bankë.</p> <p>Departamentet funksionojnë si njësi bazë me objektiva dhe mision të qartë.</p> <p>Çdo departament ka të paktën 7 (shtatë) anëtarë efektivë të personelit akademik, 3 (tre) prej të cilëve kanë gradën shkencore “Doktor”.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Fakulteti dhe Departamentet i kanë të qarta përgjegjësitë dhe objektivat e tyre për të garantuar realizimin e programit të studimeve Master në Financë dhe Bankë.</p> <p>Fakulteti dhe Departamentet përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit dhe mbështesin vazhdimisht personelin akademik në funksion të rritjes së nivelit profesional dhe akademik.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimi i Universitetit EPOKA është ndërtuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në funksion të misionit të tij 2. Fakulteti dhe Departamentet janë të mirëfokusuara në zhvillimin efektiv të programit të studimeve Master professional në Financë - Bankë. 3. Universiteti ka ndërtuar një strukturë organizative që i përgjigjet objektit dhe misionit të tij. Ka hartuar aktet nënligjore të funksionimit, sic janë statutet dhe rregulloret, përfshirë procedurat që garantojnë për një mirëqeverisje të Institucionit. 4. Fakulteti dhe Departamentet përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit dhe mbështesin personelin akademik në zhvillimin profesional dhe akademik. <p>Standardet përmbushen</p>	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Referuar të dhënave të paraqitura nga RVB, takimeve në institucion por edhe vizitës në Zyrën e Burimeve njerëzore, personeli akademik i angazhuar në këtë vit akademik (2017-2018) përbëhet nga 11 vetë, të punësuar me kohë të plotë me tituj dhe grada - 1 Prof.Dr, 3 Prof.Dr.Asoc. dhe 7 Dr. Nuk ka Personel me kohë të pjesshme (PAK) të angazhuar në këtë program studimi në këtë vit akademik.

Raportet midis personelit me kohë të plotë, personelit me kohë të pjeshme, personelit administrativ dhe studentëve në këtë program studimi, janë si më poshtë:

Raporti PAE/PAK në këtë program është 11/0

Raporti Personel akademik/Personel administrativ është 11/4=2.75

Raporti Personel akademik/Student është 11/18=0.61

Raporti Personel administrativ/Student është 4/18=0.20

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, Personeli akademik i angazhuar në këtë program është i gjithi efektiv i punësuar në Universitetin Epoka. Ai përbëhet nga:

1. U. Ergun - Përgjegjës Dept -. Prof. Asoc. Dr.
2. T. Duman – Pedagog - Prof. Dr.
3. E.Hysa - Pedagog - Prof. Asoc. Dr.
4. M. Uç - Pedagog - Prof. Asoc. Dr.
5. Xh. Hysa - Pedagog Asist. - Prof. Dr.
6. Ch. Balomenou - Pedagog -Dr.
7. V. Gambarov - Pedagog - Dr.
8. P. K. Kabeya - Pedagog - Dr.
9. N. Mera - Pedagog - Dr.
10. T. Hagen - Pedagog - Dr.
11. N. U. Rehman - Pedagog - Dr.

Për tre vitet e fundit, referuar të dhënave të paraqitura nga Institucioni në DVV, personeli akademik i cili ka mbuluar këtë program studimi paraqitet si më poshtë:

2016-2017 – 6 PAE (1 Prof. Dr; 2 prof. As; 3 Dr) dhe 5 Pak (5 Dr)

2015-2016 – 6 PAE (2 Prof As; 3 Dr; 1 Msc) dhe 3 PAK (3 Dr)

2014-2015 - 6 PAE (4 Dr; 2 Msc) dhe 2 Pak (2 Dr)

Të dhëna më të detajuara të përbërjes së stafit, me titull dhe me gradë, ndodhen në Anekse Tabela 4 dhe 4/1, 4/2 dhe 4/3.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

Keshilli shkencor dhe koordinatorët e programit të studimit:

- U. Ergun Prof.Dr.Asoc. Kryetar, koordinator i programit
- Ch. Balomenou Dr. Anëtare
- P. K. Kabeya Dr. Anëtare
- N. Mera Dr. Anëtar

- Erisa Gerbeti Znj. Raportuese

Të dhëna për Këshillin shkencor të programit jepen në Anekse, tabela 4/4

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre për vitin 2017-2018, ndodhen më poshtë, ndërsa për ndër vite, për moshën gjenden në Anekse, tabelat 4 dhe 4/1

Titulli	Stafi akademik i Programit të Studimit (Viti akademik 2017-2018)		
	PAE	PAK	Raporti PAE/PAK
Profesorë	1	0	1/0
Profesorë të Asociuar	3	1	3/1
PhD	7	3	7/0
Pedagogë ne proces Dr.	-	-	-
Asistentë me Msc	-	-	-
Personel Administrativ	4	0	4/0

Të dhëna sipas moshës e PAE dhe PAK me kohë të plotë

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik dhe Administrativ me kohë të plotë për çdo grupmoshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë			1		
Profesorë të Asociuar		3			
PhD	1	5		1	
Pedagogë ne proces Dr.					
Asistentë me Msc					
Personel Administrativ	4				

Të dhëna sipas moshës të personelit akademik me kontratë*

Personeli sipas titujve /gradave	Numri i Personelit Akademik me kohë të pjesshme për çdo grupmoshë:				
	(25-35)	(36-45)	(46-55)	(56-65)	(66-68)
Profesorë					
Profesorë të Asociuar					
PhD					

Pedagogë ne proces Dr.					
Asistentë me Msc					
Personel Administrativ					

*Nuk ka personel akademik me kontratë për këtë program studimi

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Gjatë vizitës në Universitetin EPOKA, u verifikuan dosjet me kontratat e punës së tre pedagogëve të përzgjedhur me sistem rastësor dhe u konstatua se ato përmbajnë të gjithë elementët e nevojshme në pajtim me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Gjatë vizitës dhe intervistave të zhvilluara me stafin ndihmës, u vërejt se ata përzgjidhen me procedurë konkurrese dhe se cilësia e tyre është në nivelin që kërkohet nga Institucioni

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>GVJ konstaton se personeli akademik, ai ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen nga Institucioni ne pajtim me objektivat e programit te studimeve.</p> <p>I gjithë personeli i angazhuar në program kryen role dhe funksione që janë në pajtim me strategjitë zhvillimore të përfshira në Planin Strategjik të Universitetit</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion me drejtuesit e Fakultetit dhe Përgjegjësin e departamentit, GVJ ju komunikua se rekrutimi I personelit akademik fillon që nga njësia bazë. Kjo njësi bën thirrje nisur nga nevojat që ka. Në këtë vit akademik një thirrje e tillë është bërë në nivel ndërkombëtar. Për pedagogët e rinj të cilat i përgjigjen thirrjes, si fillim realizohet një skypecall dhe pastaj filloheshin të gjitha procedurat për rekrutimin e stafit.</p> <p>Personeli akademik ka rolin kryesor në hartimin e kurrikulës, dhe në përgatitjen e vendimeve të Universitetit, të cilat lidhen me programin e studimit. Rishikimi dhe përmirësimi i kurrikulës bëhet përmes një konsultimi të gjerë me shumë aktorë nga brenda e jashtë Universitetit</p> <p>Universiteti ka përcaktuar procedura për rekrutimin e personelit dhe përcaktimin e ngarkesës mësimore, të cilat janë në pajtim me</p>

	aktet ligjore e nënligjore dhe rregulloret e Universitetit.
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Universiteti ka hartuar një udhëzim specifik për rekrutimin e personelit. Rekrutimi i stafit ndiqej sipas procedurave të përcaktuara nga Institucioni por edhe nga Departamenti i cili kërkon staf të ri. Personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në "Masterin Profesional Financë-Bankë" mbulon 100% të orëve totale të programit. Institucioni ka hartuar një rregullore të vecantë dhe zbaton procedura transparente për vlerësimin e personelit. Universiteti ka ndërtuar një model të mbajtjes së të dhënave, ku përfshihen njoftimet, raportet e rekrutimit të personelit, dhe dokumente të tjera.</p>
Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin "Profesor i asociuar" ose, gradën shkencore "Doktor" ("PHD") të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve "Master i Shkencave" ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve "Master profesional" ka të paktën gradën shkencore "Doktor" ose, diplomën "Master Profesional" ose "Master Shkencash" dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Përgjegjësi i Programit Master Profesional në Financë-Bankë mban titullin "Profesor i Asociuar".</p> <p>GVJ nga kqyrja e syllabuseve konstatoi se lëndët e këtij programi jepen nga pedagogë që mbajnë të paktën gradën "Doktor"</p> <p>Rektori, zv. Rektori, Përgjegjësi dhe zv.përgjegjësi i qendrës ndëruniversitare, Dekani, zv.Dekani dhe Përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit dhe përgjegjësi i programit janë personel i punësuar me kohë të plotë.</p>
Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Studentët në Masterin Profesional në Financë-Bankë kanë udhëheqës akademik.</p> <p>Në semestrin e fundit të programit, studentëve iu caktohet një udhëheqës teze. Udhëheqësit e tezës takohen në mënyrë sistematike me studentët, gjatë të cilave bëhet orientim i studentëve sidomos për kërkimin dhe shkrimin e tezës.</p> <p>Udhëheqësit e tezës kanë të paktën gradën shkencore "Doktor".</p> <p>Aktualisht, në Masterin Profesional në Financë-Bankë një udhëheqës mbikëqyr rreth 3 studentë.</p>
Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.	

<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Fushat kërkimore të udhëheqësve të programit të studimit “Master Profesional në Financë-Bankë” janë në përputhje me fushën e studimit të programit Master. Disa nga fushat janë Teoria Financiare, Financat Ndërkombëtare, Menaxhimi Financiar, Bankat, etj.</p> <p>Udhëheqësit e tezave kanë përfunduar studimet e doktoratës në universitetet e SHBA-së, UK, Greqisë, Turqisë, Italisë, Malajzisë dhe Shqipërisë, vazhdojnë kërkimin shkencor dhe marrin pjesë rregullisht në konferencat shkencore.</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Universiteti ka tre laboratorë informatike dhe zyra e TI-së mirëmban laboratorët dhe infrastrukturën tjetër që nevojitet për të kryer punë konkrete laboratorike. Universiteti angazhon një numër optimal të personelit akademik dhe administrativ në funksion të përmbushjes së kërkesave dhe objektivit të programit të studimeve</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore vlerësohet me orë mesimore dhe llogaritet në bazë të numrit të orëve leksion dhe seminar, në përputhje me Udhëzimin "Për ngarkesën mësimore"</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Universiteti ka një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik, e cila mbahet në nga Zyra e Burimeve Njerëzore.</p> <p>Ai ka listën e plotë të personelit akademik, mësimor-shkencor, mbështetës dhe administrativ, e cila përditësohet çdo semestër dhe shpallet në faqen e internetit të Departamentit.</p> <p>Perpara nisjes së semestrit, Universiteti publikon rregullisht listen e pozicioneve akademike vakante dhe kriteret në faqen e internetit të Universitetit dhe në faqe interneti ndërkombëtare për burimet njerëzore, si jobs.uk, Acadeus</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti zbaton procedura dhe politika të përshtatshme për përzgjedhjen e personelit akademik që nevojitet për programin “Master Profesional në Financë-Bankë. 2. Kurrikula e programit, caktimi i lëndëve, ngarkesa mësimore dhe nevojat për personel akademik diskutohen rregullisht në mbledhjet e Departamentit të Financë-Bankës. 3. Universiteti garanton caktimin e Udhëheqësve të përshtatshëm të tezës së studenteve, me të paktën titullin Dr, të cilët i kushtojnë studentit kohën e mjaftueshme. 4. Cdo lëndë ka klasën e caktuar, sallën e leksioneve, studion apo laboratorin kompjuterik 5. Zyra e Burimeve Njerëzore ndjek procedurën e miratuar të rekrutimit të personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, e cila mban parasysh rolin e Departamentit të Financë-Bankës, nevojat për burime njerëzore, etj. 	

6. Ngarkesa e punës e personelit akademik përcaktohet në bazë të Kodit të Punës së Shqipërisë dhe rregullores së brendshme për ngarkesën mësimore. Orët mësimore llogariten sipas Udhëzimit të Këshillit të Lartë dhe rregullores së brendshme për ngarkesën mësimore.

7. Universiteti organizon rregullisht seanca trajnimi për anëtarët e personelit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, me qëllim që të njihen me vendimet më të fundit për organizimin e procesit mësimor, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, përdorimin e sistemeve elektronike dhe çështje të ngjashme..

Në programin Master Profesional në Finance - Bankë është i angazhuar një numër i mjaftueshëm personeli akademik dhe administrativ.

Standardet përmbushen.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Universiteti "EPOKA" ndodhet në rrugën Tiranë-Rinas, në kilometrin 12. Kampusi (rezidencat) shtrihet në një sipërfaqe totale 67 000 m². Viti akademik 2017-2018 zhvillohej rregullisht në mjediset e dy godinave me sipërfaqe totale 14 352 m². Gjatë vizitës në institucion, GVJ i kushtoi vëmendjen e duhur edhe ambjenteve në funksion të këtij programi studimi. U vizituan disa salla leksionesh dhe seminaresh si edhe laboratorit kompjuterik dhe Zyra e Koordinimit të Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit (ICTCO). Ambjentet në funksion të programit janë të bollshme, me ajër të kondicionuar, të pajisura me vidioprojektor dhe smart borde të cilat ashtu sic edhe na u komunikua mundesojnë një zhvillim normal të procesit mësimor. Kjo gjë na u pohua edhe nga takimi me stafin dhe studentët. Gjithashtu u vizitua nga GVJ edhe ambjentet shlodhëse për studentët dhe stafin, biblioteka, mjediset sportive, etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (Plotëso Tabelat në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)

- Salla për leksione 5
- Klasa për seminare 17
- Salla për aktivitete promovuese 1
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale 2
- Laboratorë për lëndët 3
- Laboratorë informatike 2
- Salla interneti 2
- Salla për bibliotekë 1
- Mjedis për fotokopjime, librari etj 1
- Zyrë informacioni për studentët 2
- Nyje hidrosanitare 89

Mjediset për stafin:

- Mjedise për Dekanin/ kancelarin 5
- Zyra për sekretarinë mësimore 2
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore 12
- Zyra për personelin akademik 40

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>Universiteti ka vendndodhje të përhershme dhe zotëron kampusin e tij, të cilat janë organizuar në mënyrë të përshtatshme për qëllime të programit të studimit.</p> <p>Orët e mësimi të programit të studimeve Master Profesional në Financë-Bankë zhvillohen kryesisht në godinën E të kampusit.</p> <p>Universiteti zbaton një sistem të duhur që garanton menaxhimin dhe kontrollin e vazhdueshëm në funksion të arritjeve e standardeve për zbatimin e politikave përkatëse arsimore.</p>
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se Universiteti "EPOKA" ka vënë në dispozicion një gamë të gjerë tekstesh dhe literature shtesë, të cilat përditësohen vazhdimisht.</p> <p>Literatura, e cila është e kohëve të fundit, pasurohet dhe vihet në shërbim të studentëve.</p> <p>Universiteti "EPOKA" ka akses edhe në disa biblioteka online ku studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra dhe punime shkencore. Biblioteka e Universitetit "EPOKA" disponon një numër të madh librash dhe literaturë të pasur si në format të shtypur, edhe në format elektronik. Librat janë kryesisht në dy gjuhë: anglisht dhe shqip. Këta libra bashkë me literaturën e ofruar në bibliotekë janë në shërbim dhe në funksion si të studentëve edhe të stafit të interesuar.</p> <p>Bazuar në literaturën e kërkuar dhe kërkesat e veçanta të personelit mësimdhënës përgatitet një listë me tituj librash dhe artikujsh, e cila i paraqitet Përgjegjësit të Departamentit. Me miratimin e tij dhe të Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit, librat e kërkuar blihen nga përfaqësuesit e bibliotekës nën mbikëqyrjen e ZTIK-ut sipas buxhetit vjetor të alokuar për këtë qëllim specifik</p>
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, siç edhe e theksuam edhe më lart, GVJ konstatoi se Institucioni ka në sasi të mjaftueshme laboratorë, klasa, zyra, studio dhe mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit për realizimin e programit të studimeve.</p>

<p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Të gjitha klasat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e një procesi mësimor të përshtatshëm dhe efektiv.</p> <p>Laboratorët dhe mjediset e tjera janë plotësisht të pajisura me të gjitha mjetet, programet dhe pajisjet e nevojshme, aksesin në internet, përfshirë ajërin e kondicionuar me sisteme ngrohje-ftohje.</p> <p>Kompjuterët e klasave dhe kompjuterët në laboratorë përmbajnë të gjithë programet dhe paketat e nevojshme për lëndët specifike të këtij programi studimi.</p> <p>Universiteti ka tre laboratorë informatike për të përmbushur nevojat e programit të studimeve Master profesional në Financë Bankë për lëndë të tilla si Metodatat Kërkimore dhe Ekonometria Financiare Avancuar, etj</p>
---	---

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Pas vizitës në mjediset e Universitetit EPOKA ekspertët e jashtëm konstatuan se mjediset, infrastruktura, logjistika dhe shërbimet e ofruara për programin e studimeve Master Profesional Financë-Bankë janë në përputhje me standardet e kërkuara dhe kriteret e përcaktuara.
2. Universiteti "EPOKA" ka vendndodhje të përhershme dhe një kampus modern që ofron një gamë të gjerë shërbimesh dhe mjedisesh ku aktiviteti mësimor i programit të studimeve zhvillohet në mënyrën më të mirë.
3. Universiteti "EPOKA" ka një fond të pasur me tekste mësimore bashkëkohore dhe literaturë shtesë që përditësohet vazhdimisht, si edhe ka akses në shumë biblioteka dhe revista shkencore elektronike, ku personeli dhe studentët mund të lexojnë dhe të shkarkojnë libra dhe artikuj shkencorë të plotë.
4. Librat dhe artikujt janë në disa gjuhë dhe përditësohen e pasurohen sipas nevojave dhe kërkesave të personelit mësimdhënës dhe udhëheqësve të tezës brenda buxhetit të alokuar për këtë qëllim,
5. Universiteti "EPOKA" ka një numër të mjaftueshëm laboratorësh, klasash, zyrash, studiosh dhe mjedisesh të tjera të pajisura me pajisje elektronike dhe teknologji informacioni për realizimin e programit të studimeve, të cilat janë të pajisura me mjetet, programet dhe pajisjet, që mundësojnë mjedis optimal dhe ofrojnë metodologji mësimdhënëse efektive duke përdorur TIK.

Bazuar në vizitën në terren dhe diskutimet me pjesëtarët e GVB-së por edhe të stafit administrativ, Ekspertët e jashtëm arrijnë në përfundimin se Standardet përmbushen.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Gjatë shqyrtimit të RVB por edhe gjatë takimeve me aktorët e duhur për këtë rubrikë, GVJ konstaton se pjesa më e madhe e të ardhurave të Universitetit vjen nga tarifa e shkollimit të studentëve. Informacioni më i detajuar për të ardhurat dhe financimet e ndryshme në 6 vitet e fundit, gjendet në Aneksë, Tabela 5.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi për vitin 2017 - 2018 (në përqindje):
- Grantet për kërkim 7.2 %
 - Konsulencat, shërbimet



- Tarifat për dhe gjatë shkollimit 92.55 %
- Sponsorizimet
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj) 0.3%

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)

Shpenzimet per 2017- 2018 në programin Financë - Bankë llogariten në 2,37 milion lekë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifrat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Gjatë takimit me GVB, ekspertëve të vlerësimit ju komunikua se: Turgut Ozal Education sh.a kryen auditim vjetor të jashtëm lidhur me situatën financiare Raporti përmban pasqyrat financiare dhe një opinion të audituesit të jashtëm të shoqërisë.</p> <p>Në pasqyrat financiare të audituara përfshihen të dhënat lidhur me të ardhurat (grantet, tarifrat e studentëve) dhe shpenzimet për shërbimet që ofron direkt ose indirect. Universiteti duhet të përcaktojë TORs, ku auditimi të shkojë më në detaje në lidhje me aktivitetin e tij, pavarësisht auditimit të shoqërisë Turgut Ozal Education, pasi kështu do të mund të kemi një analizë më të hollësishme të përdorimit të të ardhurave dhe të rritjes së eficientës së tyre</p>
Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Raporti financiar hartohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh. a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori. Me finalizimin e raportit të hartuar, të dhënat dhe analizat i komunikohen Universitetit "EPOKA", i cili funksionon me buxhet të varur. Nga raporti financiar i Turgut Ozal Education sh. a., verehet se shoqëria ka bilanc vjetor pozitiv dhe qëndrueshmëri financiare që garanton përparimin e Universitetit.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtuesi i Fakultetit dhe ai i Departamentit duhet të njihen me raportin financiar, pavarësisht se ai hartohet në mënyrë të centralizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Turgut Ozal Education sh.a. çdo vit dhe arkivohet në këtë Drejtori. 2. Shoqëria që zotëron Universitetin kryen auditimin e pasqyrave financiare, megjithatë, duhet të përgatiten TORs për audituesin e jashtëm për të audituar specifikisht, ndoshta edhe me një raport të 	

veçantë, aktivitetin e Universitetit EPOKA, për të nxjerre në pah problematikat dhe për të shtuar vlerë në lidhje me eficientë.

3. Shoqëria Turgut Ozal sha ka bilanc vjetor pozitiv që garanton performancën dhe vazhdimësinë e Universitetit
4. Institucioni kryen audit vjetor të situatës financiare.

Bazuar në diskutimet me drejtuesit e Fakultetit dhe të departamenteve, ekspertët e jashtëm mendojnë se Standardet plotësohen.

Rekomandojmë që audimi i shoqërisë Turgut Ozal Education sh.a., të ketë terma më specifike për auditimin e veprimtarisë në Universitetin EPOKA, (pavarësisht faktit që kryhet një auditim financiar i përvitshëm për treguesit financiare).

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

GVJ gjatë vizitës në Institucion kishte të planifikuar një takim të posaçëm me Njësinë e Sigurimit të Cilësisë në këtë Institucion. Sipas drejtuesve të kësaj njësie, institucioni ka ngritur dhe zbaton një sistem të duhur të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë, bazuar në kërkesat e legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë, manualin dhe udhëzimet e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimit të Lartë të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitat e Statutit dhe Rregullores Themelore të Universitetit "EPOKA". Gjithashtu GVJ-së ju komunkua se: Sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë në Universitetin "EPOKA" funksionon përmes Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë (KPSC), që mbështetet në punën e tij nga Zyra e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë. Njësia e Sigurimit të cilësisë përbëhet nga tre zyra: Zyra për sigurimin e brendshëm të cilësisë; Bordi i provimeve dhe Komisioni për zhvillimin e kurikulës. Secila zyrë funksiononte në shërbim të ngritjes së cilësisë. Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të cilësisë përbëhet nga 11 anëtarë, nga të cilët njëri ishte Ekspert i jashtëm. Në takimin me GVJ të pranishëm ishin tre anëtarë të këtij Komisioni.. Eshtë ndryshuar Udhëzimi "Për vlerësimin akademik dhe përmirësimin e cilësisë në Universitetin EPOKA", me qëllim pasqyrimin e kriterëve të Udhëzimit për ngritjen dhe funksionimin e Sistemeve të Brendshme të Sigurimit të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Manualin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë në Institucionet e Arsimit të Lartë, miratuar në tetor 2012 nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Funksionet e sigurimit të cilësisë në Universitetin "EPOKA" ushtrohen në nivel departamenti, në formatin peer review.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:
- Sa anketime kanë bërë me studentët
 - Sa studentë janë anketuar
 - Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
 - Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
 - Etj

GVJ ju komunikua se KSBC bën anketime të studentëve dy herë në vit, para mbarimit të çdo semestri. Kjo për arsye që plotësimi i tyre mos të ndikojë në vlerësimin e stafit në mënyrë të gabuar, nisur nga rezultatet e provimeve, por në një pyetësor sa më të drejtë dhe me problematika aktuale. Nuk kanë patur raste të shkarkimit apo largimit të pedagogëve si pasojë e sjelljes jo korekte me studentët. Edhe pse pyetësoi plotësohet nga studentët para provimeve, pedagogu mund ta shikojë këtë vlerësim pas përfundimit të provimeve. Gjithçka realizohet si një proces i mbyllur dhe transparent. Në këtë program studimi ka patur gjithmonë një numër të vogël studentësh dhe nuk janë specifikuar problematika të cilat lidhen me procesin e mësimdhënies, raportin pedagog student por edhe raportin student personel administrativ. Pyetësoi është plotësuar nga të gjithë studentët.

Të dhëna të detajuara për kontrollin e cilësisë jepen në tabelën 6 në Aneksë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përbëhet nga të paktën tetë (8) anëtarë, mes te cilëve një kryetar, një anëtar të personelit akademik me kohë të plotë (efektiv) nga cilado njësi kryesore me të paktën gradën shkencore "Doktor" dhe pa detyra menaxhimi të nivelit të lartë, të paktën dy anëtarë të personelit administrativ, një përfaqësues të studentëve të Universitetit, si edhe një specialist i jashtëm me përvojë të pasur në çështjet e sigurimit të cilësisë që zgjidhet nga Senati Akademik, për një periudhë dy-vjeçare me të drejtë rizgjedhjeje. Zv.Kryetari i Këshillit Studentor për çështjet e sigurimit të cilësisë është gjithashtu anëtar i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë.

Në të gjitha rastet, vendimet merren me shumicë të thjeshtë dhe me pjesëmarrjen e të paktën gjysmës së anëtarëve të Komisionit. Në rast barazie votash, vota e Kryetarit është vendimtare. Funkcionimi i Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë përcaktohet në rregullore të posaçme.


Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë është përgjegjës për:

- Hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë, akteve që miratohen nga Senati Akademik.
 - Zhvillimin e standardeve të sigurimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Cilësisë, të miratuar nga Senati Akademik.
 - Mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave, procedurave dhe standardeve për sigurimin e cilësisë në universitet.
 - Kryerjen e vlerësimit periodik të rezultateve të veprimtarive arsimore dhe kërkimit shkencor, monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive që ndërmerren në kuadrin e vlerësimit akademik dhe administrativ, përmirësimin e cilësisë përmes raporteve të vlerësimit, inspektimit periodik dhe monitorimit të përmirësimit të cilësisë në universitet;
 - Planifikimin dhe koordinimin e zbatimit të procedurave të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit, si edhe të programeve të studimit, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm, standardet kombëtare të cilësisë, rregulloret, udhëzimet dhe politikat e procedurat e Universitetit
- Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë gëzon autonomi operative dhe akses në të dhënat e institucionit dhe raporton te Senati Akademik rezultatet dhe propozimet përkatëse..

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

NjSBC i komunkoi GVJ-së se: Universiteti "Epoka" periodikisht dhe në përputhje me kalendarin e akreditimit dhe riakreditimit të Universitetit dhe të programeve të veta të studimit, harton raporte vetëvlerësimi sipas dispozitave të legjislacionit shqiptar për arsimin e lartë dhe sipas udhëzimeve që merr nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë të Republikës së Shqipërisë.



Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Me qëllim garantimin e vetëdijes së personelit akademik dhe administrativ për rëndësinë e marrjes së një kulture cilësore nga secila njësi e Universitetit "EPOKA", KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, realizon seminare trajnimi dhe informimi periodike për personelin e institucionit, në lidhje me komponentët e ndryshëm të cilësisë dhe rëndësinë që ka sigurimi e cilësisë në përgjithësi dhe sistemet e menaxhimit të cilësisë në veçanti.

Universiteti "EPOKA" është pajisur me Certifikatën ISO 9001: 2008 për Sistemet e Menaxhimit të Cilësisë, ripërtëritja e të cilës sipas kritereve të ISO kryhet çdo tre vjet. Auditimi i jashtëm i fundit në kuadër të ISO është kryer në mars 2014. Për të mbikëqyrur zbatimin e drejtë të të gjitha proceseve dhe procedurave të përcaktuara në ISO, Universiteti "EPOKA" ka ngritur Grupin e Auditimit të Brendshëm, i cili siguron zbatimin e proceseve dhe procedurave të institucionit.

KPSC me mbështetjen e Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë, kryen kontrole periodike dhe anketime me secilën njësi akademike dhe administrative të Universitetit, si dhe përgatit raporte që ia përcjell Rektoratit dhe njësisve përkatëse, në mënyrë që të adresohen mangësitë e identifikuara dhe të zgjidhen problemet e vërejtura në njësitë përkatëse.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; Etj. <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në 	<p>GVJ thekson se: Universiteti EPOKA, përmes Zyrës së Brendshme të Sigurimit të Cilësisë dhe përmes komisioneve të veta, vlerëson periodikisht efikasitetin e mësimdhënies, kërkimit dhe aktiviteteve administrative. Universiteti publikon raportin e vetëvlerësimit institucional.</p> <p>Rezultatet e vlerësimit shërbejnë për të përmirësuar programet e studimit.</p> <p>për kryerjen e vlerësimit përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta. Në metodat e tërthorta përfshihen anketimet e studentëve, rezultatet e të cilave ndihmojnë për rivlerësimin e përmbytjes së lëndëve të programit. Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe programeve të studimit. Përmes anketave, studentët japin opinionin e tyre për pedagogët dhe përmbytjen e lëndës, për shërbimin e ofruar nga Universiteti, pyetje konceptuale etj.</p> <p>Mënyrat direkte të vlerësimit përfshijnë analiza të treguesve specifike, si për shembull Vlerësimi me pikë i pjesëmarrjes së studentit në orët e mësimi; Vlerësimi I studentëve me notë; Vlerësimi i detyrave të realizuara nga studentët; Vlerësimi i përfshirjes së studentëve në aktivitete jashtëshkollore.</p> <p>Gjithashtu, pedagogët iu kërkojnë studentëve komente, Dekanati i Fakultetit takohet me studentët, këshilltarët takohen me studentët dhe studentët kanë kanal formal për të shprehur shqetësimet e tyre përmes Senatit të Studentëve dhe Dekanit të Studentëve.</p>

<p>grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</p> <p>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</p> <p>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p> <p>h. Etj.</p>	
<p>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" publikon rregullisht broshura për vlerësimin e brendshëm, të cilat përfshijnë rezultate të anketave periodike të personelit dhe studentëve</p> <p>Universiteti "EPOKA" publikon në faqen e internetit të KPSC-së analiza dhe raporte të vlerësimit të jashtëm dhe të brendshëm të të gjitha cikleve të studimit.</p>
<p>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" përgatit analiza vjetore ku vlerëson ecurinë e programeve të studimeve të nivelit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, ku përfshihen të dhëna për aspektet akademike, të dhëna për performancën e studentëve, si norma e kalueshmërisë dhe të dhënat për mësimdhënien</p> <p>Gjithashtu, Universiteti harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p>
<p>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programit të studimeve. Ri-akreditimi më i fundit institucional i Universitetit "EPOKA" është realizuar nga ASCAL në bashkëpunim me agjencinë britanike QAA në vitin 2017. Rezultatet konfirmuan se Universiteti "EPOKA" përmbush standardet e kërkuara. Programet e studimit përmirësohen bazuar në rezultatet e vlerësimit të tyre nga personeli akademik dhe studentët.</p> <p>Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Vepriartaria e Universitetit ka për qëllim ndërgjegjësimin e personelit dhe të studentëve për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>institucioni ka publikuar dhe zbaton strategjine për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Universiteti "EPOKA" analizojnë çdo vit ecurinë e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të studimeve të integruara të ciklit të dytë, përfshirë programin Master profesional në Financë - Bankë 2. Universitetit "EPOKA", harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve 3. Universiteti ka përmbushur standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional para aplikimit për ri-akreditimin e programit Master profesional në Financë - Bankë. 	

4. Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë dhe mekanizma formale për shqyrtimin periodik, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimeve, me qëllim rritjen dhe ndërgjegjësimin e personelit e të studentëve për rëndësinë e cilësisë,
5. Universiteti përdor metodologji vlerësimi, publikon raportet e vetëvlerësimit si dhe publikon rezultatet e vlerësimit.
6. Studentët përfshihen në vlerësimin e pedagogëve dhe të zhvillimit të programeve të studimeve.
7. Për të bërë transparent vlerësimin e brendshëm, institucioni publikon në faqen e internetit të KPSC-së analizat dhe raportet e vlerësimeve të brendshme dhe të jashtme

Standardet përmbushen

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas dokumentacionit dhe deklarimeve të bëra gjatë vizitave në Universitetin "Epoka" theksohet se misioni i Departamentit Financë-Bankë është të përmbushë nevojat për profesionistë të kualifikuar në sektorin Financë-Bankë dhe të përgatitë individë të kualifikuar për organizatat private, publike dhe jofitimprurëse.

Programi i studimit Master Profesional Financë-Bankë është i përbërë nga një kompozim i harmonizuar i një numri lëndësh teorike dhe teknike duke pasur si synim të pajisë studentët me njohuri të avancuara në fushën e financave. Programi i studimeve Master Profesional në Financë - Bankë ofrohet nga Departamenti i Financë-Bankës, që është në përbërje të Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative. Në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë dhe aktet nënligjore të tij, Universiteti "EPOKA" u licencua në mars 2008. Departamenti i Financë-Bankës vepron si njësi bazë kërkimore e cila përfshin fusha homogjene të kërkimit në disiplinën e Financë-Bankës.

Në semestrin e parë, studentët njihen me koncepte të avancuara teorike dhe praktike në zhvillimet më të fundit strategjike, menaxheriale dhe industriale në tregjet financiare vendore dhe globale, me theks të veçantë të rastet studimore dhe problematikat bashkëkohore. Po ashtu, gjatë masterit studentëve iu jepet orientim i veçantë që të përmirësojnë aftësitë kërkimore dhe të kryejnë me sukses kërkimin vetë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Viti i fillimit të programit Master Profesional në Financë Bankë është viti 2011

Qëllimi i studimit në këtë master është që tju trasmetoj studentëve dije të qëndrueshme në fushën e Finacës dhe bankave duke lidhur njohuritë teorike me ato praktike

Ky program ka në fokus përgatitjen e specialistëve të kualifikuar që t'i shërbejnë me cilësi nevojave të tregut të punës. Në programin Master Profesional në Financë - Bankë, studentët fitojnë njohuri mbi çështje të ndryshme të financave dhe shoqërinë, si edhe zhvillojnë aftësitë e shkrimit dhe komunikimit, aftësitë e fituara prej lëndëve të parashikuara në programin e studimeve, përgatisin studentin që të punojë më pas në institucionet publike ose private.

Referuar Rregullores se programit të studimit, si dhe RVB, objektivat e Programit të Masterit Profesional në Financë-Bankë janë:

1. Përftimi i koncepteve të avancuara që lidhen me fushat e financës dhe bankave si dhe përdorimin efikas të tyre;
2. Integrimi i teorikes, praktikave dhe politikave të ndryshme, në mënyrë që studentët të kuptojnë mënyrën si funksionojnë politikat financiare dhe bankare;
3. Krijimi i parakushteve për zhvillim të vazhdueshëm si rezultat i ofrimit të programeve shumë cilësore dhe konkurruese në tregun vendas dhe global;
4. Ndërgjegjësimi i studentëve për të kontribuar për komunitetin;
5. Të kuptuarit dhe ndërgjegjësimi me të mësuarit gjatë gjithë jetës në mënyrë që t'i përshtaten tregut të punës;
6. Përcjellja e trendeve globale në fushën e shkencës dhe praktikës financiare;
7. Përgatitja e kuadrove me aftësi të lartë në teori dhe praktikë në fusha të ndryshme të financës në Shqipëri, rajon dhe përtej;
8. Përgatitja e liderëve me formim të thelluar profesional dhe shkencor në fushën e financës, bankave dhe kërkimit;
9. Përgatitja e liderëve me formim të thelluar në fushën e financave në vend.

Duke u organizuar në 2 semestra, programi iu ofron studentëve koncepte të avancuara teorike dhe praktike në tregjet financiare vendore dhe globale, me theks të veçantë te rastet studimore dhe problematikat bashkëkohore. Në këtë program, studentët orientohen që të përmirësojnë aftësitë kërkimore dhe të kryejnë me sukses kërkimin të pavarur. Departamenti i Financë Bankë i kushton vëmendje edhe aktiviteteve jashtëkurrikulare të studentëve dhe integritimit më të mirë me shoqërisë. Ndër aktivitetet jashkurikulave përmendim:

1. Leksione të hapura ku ftohen figura të njohura, ekspertë nga Shqipëria dhe të huaj në fushën e financave;
2. Vizita në organizata të ndryshme financiare;
3. Pjesëmarrje në konkurse të ndryshme.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Ky program është i organizuar në 1 vit akademik me 2 semestra

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor

- 1 vit akademik ka 480 orë mësimore në auditor
- (5 lëndë*3 orë*16 javë*2 semestra)
- 1 semestër ka 240 orë mësimore në auditor, përfshirë periudhën e provimeve
- - (5 lëndë*3 orë*16 javë)
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60 minuta

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Informacioni më i detajuar jepet në Aneks Tabelat 7, 7/1, 8 dhe 9

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

Për leksionet 480 orë në auditor dhe 1020 orë punë e pavarur e studentit

Për seminarët 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Për laboratorët 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Për praktika lëndore 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Për praktika Profesionale 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Provimi përfundimtar 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Nuk janë bërë ndryshimet e rekomanduara lidhur me planin dhe programin mësimor në krahasim me programin e licensimit filestar. Ka shumë lëndë me zgjedhje dhe pak lëndë bazë
Shiko Tabelën 7/1 në Aneks

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Në shumicën e rasteve personeli akademik është stabilizuar në lëndët mësimore dhe i jep ato prej vitesh. Duhet bërë më shumë përpjekje për stafin me kohë të pjesëshme për të qenë më i stabilizuar dhe të jenë nga specialistët më të mirë që ka tregu në fushat përkatëse.

Në vitin akademik 2017-2018, si personel mësimdhënës në këtë program studimi është angazhur vetëm personel i brendshëm, i përbërë nga 11 pedagogë nga të cilët 1 Prof. Dr; 4 Prof. As dhe 6 Dr. Të dhëna më të detajuara për përbërjen e stafit, titull dhe gradë, ndër vite, gjenden në Aneks, Tabela.9

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studentit për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Syllabuset e të gjitha lëndëve janë sipas elementëve standard më sipër

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Në shumicën e rasteve syllabuset janë bashkëkohore dhe kanë elementë të përbashkët me eksperiencat më të mira të universiteteve Europiane dhe të ShBA por ka raste kur duhen përmirësuar syllabuset si psh syllabusi i lëndës Metoda kërkimi në financë është shumë standart (besoj se do jetë i njëjti edhe në masterat e degëve të tjera) dhe ka pak elementë specifik të kërkimit shkencor në financë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas	Universiteti Epoka ofron për studentët e këtij programi studimi një program të akredituar, të organizuar në module, të cilat vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe

<p>Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është konceptuar në përputhje me programin e licencuar nga Ministria e Arsimit Sportit dhe Rinisë. Sasia mesatare e krediteve të akumuluar gjatë një viti nga studenti që ndjek programin e studimeve me kohë të plotë në Master Profesional në Financë Bankë është 60 kredite</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve “Master Profesional” kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p>Bazuar në rregulloren për ciklin e dytë të studimeve dhe nga dokumentacioni në dispozicion theksojmë se programi i ciklit të dytë “Master Profesional në Financë Bankë” i pajis studentët që zotërojnë diplomën <i>Bachelor</i> me njohuri të thelluara të fushës në nivelin teorik dhe praktik, si edhe i trajnon ata për kërkim shkencor të pavarur.</p> <p>Basuar në njohuritë e fituara në nivelin Bachelor të studimeve, ky program studimesh synon të zgjerojë njohuritë e përfituara gjatë studimeve të ciklit të parë. Kjo shprehet si në Rregulloret e Studimeve të Ciklit të Dytë, ashtu edhe në objektivat e kurrikulës dhe realizohet përmes programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit “Master Profesional në Financë - Bankë” i pajis studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen, kompetenca të cilat janë të shprehura qartë në silabusin e lëndëve specifike të programit.</p> <p>Programi i studimeve “Master Profesional në Financë-Bankë” fokusohet në ofrimin e një baze dijetesh solide për studentët, ka objektiva të qarta profesionale në përputhje me nevojat e tregut dhe me qëllime të qarta për përgatitjen e profesionistëve me aftësi të larta.</p>
Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Bazuar në kurrikulat dhe silabuset e lëndëve, si dhe në bisedat gjatë vizitës së punës vërehet se përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimit Master Profesional në Financë Bankë synojnë arritjen e qëllimeve të tyre bazuar në nivelin e studimeve</p>
<p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Master në të cilin ofrohen ato.</p> <p>Sylabuset e secilës lëndë janë standarte dhe në to shprehen qartë metodatat e vlerësimit, por secili pedagog ka lirinë relative të organizojë vlerësimin në përqindje të ndryshme të këtyre aspekteve. Kriteret e vlerësimit janë: provimi i mesvitet, testet, projektet, prezantimet, frekuentimi i mësimin dhe provimi përfundimtar.</p>
Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë është përgatitur dhe zhvilluar duke marrë për bazë praktika ndërkombëtare të vendeve të ndryshme evropiane. Një pjesë e personelit të angazhuar në këtë program është nga vende të ndryshme të Evropës, që kanë përvojë të konsiderueshme. Siç vërejtëm nga silabusi i secilës lëndë dhe nga kurrikula në përgjithësi, programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është konkurruese në nivel ndërkombëtar, si teknikisht (kredite evropiane, kredite SHBA, metoda vlerësimi), ashtu edhe në përmbajtje (plani mësimdhënës, literatura, etj.). Sipas rregullave të universiteteve pritëse studenti mund të ekuivalentoj studimin e bërë në këtë program me studime analoge në vende të tjera. Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është hartuar në përputhje të plotë me Sistemin e Bolonjës dhe kërkesat e tij.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Kurrikula e Masterit Profesional në Financë-Bankë përfshin edhe përgatitjen e tezës, duke ofruar të gjitha mundësitë për përgatitje të thelluar individuale të studentit në fushën e formimit profesional. Nga dokumentacioni dhe vizita vumë re se ky program studimesh është hartuar në përputhje me profilin e Fakultetit të Shkencave Ekonomike dhe Administrative pranë Universitetit "EPOKA" dhe me strategjinë e zhvillimit të tij. (http://epoka.edu.al/mat/aeqi/Epoka-strategic-plan-2013-2017.pdf)</p> <p>Personeli akademik punon për ngritjen profesionale dhe shkencore duke u angazhuar në kërkim shkencor për realizimin e programeve të studimeve dhe përmes opsioneve të ndryshme inkurajohet nga institucioni në fushën e kërkimit shkencor. (http://feas.epoka.edu.al/home-journal-articles-442-558.html) (http://baf.epoka.edu.al/cat-academic-journal-2108.html)</p> <p>Në përzgjedhjen e personelit akademik që angazhohet në programin e studimeve Master Profesional në Financë-Bankë, Universiteti "EPOKA" i kushton rëndësi të veçantë punësimit të personelit akademik me kompetenca të larta akademike dhe profesionale. (http://baf.epoka.edu.al/home-research-areas-236-1767.html) (http://baf.epoka.edu.al/home-research-groups-236-2216.html)</p>
<p>Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Universiteti bënë përpjekje të konsiderueshme që programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë të organizohet dhe ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës (Anketa për Rezultatet e Diplomimit në Tregun e Punës; 10 Vjet me Arritje, janar 2018. (shih Shtojcën 4). (http://cpao.epoka.edu.al/cat-publications2292.html);</p> <p>Programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë synon të përmbushë nevojat e sektorëve relevantë të tregut të brendshëm. Në këtë kontekst, të dhënat makro të INSTAT dhe Vrojtimit / Anketat e Tregut të Punës tregojnë se sektori bankar dhe financiar është një nga sektorët me kërkesën më të lartë për profesionistë. (shih edhe: Raporti i Shoqatës Shqiptare të Bankave, janar 2018).</p>
<p>Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.</p>	

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Masteri Profesional në Financë-Bankë është hartuar duke mbajtur parasysh nevojat e tregut të punës dhe në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit të ekonomisë shqiptare. Ky program është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në planin strategjik për arsimin e lartë të MASR, dhe nuk bie ndesh me interesat kombëtare. Politikat e zhvillimit të departamentit janë hartuar në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës, sipas Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020.</p> <p>Një studim i plotë i tregut të punës për vlerësimin e nevojave për specialistë mungon. Por kjo mungesë është plotësuar me studime pjesore si në vijim.</p> <p>Universiteti "EPOKA" ka organizuar tradicionalisht panairë karriere në muajin Maj në kampus përmes Zyrës së Karrierës, duke iu ofruar studentëve të vitit të fundit mundësi punësimi duke i promovuar në tregun e punës.</p> <p>(http://cpao.epoka.edu.al/home-fourth-career-fair-2017-1593-2054.html)</p> <p>Praktika Profesionale është zhvilluar në shumë kompani. Universiteti "EPOKA" ka realizuar një anketë për Rezultatet e Diplomimit në Tregun e Punës: 10 vjet me Arritje" në 2017, për të parë dhe për të vlerësuar çfarë performancë kanë pasur programet e studimeve të ciklit të dytë në tregun e punës. Këtu përfshihet edhe ky program studimi</p> <p>(http://cpao.epoka.edu.al/cat-publications-2292.html)</p>
<p>Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programi Master Profesional në Financë Bankë është hartuar në përputhje me politikat kombëtare të përcaktuara në planin strategjik për arsimin e lartë të MASR dhe nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Politika e hartimit dhe e zhvillimit të këtij programi është në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit dhe nevojat e tregut të punës.</p> <p>Ky program studimit ndihmon në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe përqipet të ofroj mundësi studimi dhe të ketë edhe studentë ndërkombëtare për të promovuar kulturën dhe traditat shqiptare.</p>
<p>Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.</p>	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	<p>Masteri Profesional në Financë-Bankë realizohet me 60 kredite evropiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tij është 1 (një) vit akademik, 60 ECTS</p>
<p>Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.</p>	

<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Studentët kanë mundësi të marrin informacion të plotë për këtë program studimi në mënyra të ndryshme si në forma elektroni dhe në formë të printuara. Ato janë lehtësisht të aksesueshme.</p> <p>Secili pedagog, në orën e parë të mësimit në secilën lëndë bën prezantimin e silabusit. Ndërkohë, silabusi i secilës lëndë është i afishuar edhe në faqen e internetit të Universitetit "EPOKA" (http://eis.epoka.edu.al/). Informacioni për programet e studimeve, modulet dhe lëndët gjendet në faqen e internetit të Departamentit të Financë-Bankës (http://baf.epoka.edu.al/home-m-sc-in-banking-and-finance-1761-227.html). Silabuset mund të aksesohen përmes llogarisë studentore EIS (http://eis.epoka.edu.al/).</p> <p>Gjithashtu ka edhe materiale të prituar në dispozicion të studentëve.</p>
<p>Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.</p>	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorja e programit Master Profesional në Financë-Bankë përcakton mënyrën e diplomimit të studentëve brenda afatit të parashikuar. Departamenti i dërgon një propozim diplomimi Fakultetit, pasi studenti përfundon me sukses të gjitha kreditet ECTS të kërkuara. Pastaj, vendimi i Fakultetit i dërgohet Këshillit Administrativ të Universitetit për miratim përfundimtar. Në programin e studimit projekti final të studimeve Master Profesional në Financë-Bankë ka 12 kredite ECTS.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është i organizuar në module, që vlerësohen me kredite sipas Sistemit Evropian të Transferimit të Krediteve (ECTS) dhe i licencuar nga MASR 2. Programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë është hartuar dhe zhvilluar duke pasur parasysh praktikat ndërkombëtare të vendeve evropiane. 3. Personeli i angazhuar në këtë program është edhe nga vende të ndryshme evropiane me përvojë të gjatë dhe praktika të mira 4. Kohëzgjatja normale e programit është një vit akademik, të realizuara me 60 kredite evropiane ECTS. Programi përfshin një Projekt me 12 ECTS që është kusht për t'u dhënë për përfundimin e tij. 5. Metodot e vlerësimit janë të shprehura qartë në silabusin e secilës lëndë. Kriteret e vlerësimit janë: provimi i mesvitet, testet, projektet, prezantimet, frekuentimi i mësimit dhe provimi përfundimtar. 6. Informacioni për programet e studimeve, lëndët dhe silabuset jepet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike. Silabuset mund të aksesohen përmes EIS. 7. Nuk ka studim të plotë të tregut të punës për nevoja për specialistë por ka metoda të tërthorta vlerësimi <p>Bazuar në sa më sipër, konkludojmë se Standartet përmbushen</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ bazuar në Rregulloren e Programit të Studimeve të Ciklit të Dytë konstaton se kjo rregullore jep detaje mbi procedurat dhe rregullat për organizimin e mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesën dhe cilësinë e

realizimit, kontrollin e njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimin e brendshëm e mësimdhënies, aktivizimin e studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

- Leksione
- Seminare
- Ushtrime
- Laboratore
- Detyre
- Praktikë lëndore
- Praktikë profesionale
- Etj

Gjatë takimeve më përgjegjësin e departamentit, stafin mësimor por edhe me GVB, Ekspertët e vlerëimit morën informacion të bollshëm për procesin mësimor në tërësi për këtë program studimi. Procesi mësimor për programin e studimeve Master Profesional në Financë-Bankë konsiston në leksione, projekte, laborator, praktikë, seminare, prezantime dhe punime të tjera të ngjashme, siç parashikohet në planin mësimor në zbatim të Nenit 26 të Rregullores për Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë. Shpërndarja e ngarkesës mësimore bëhet sipas Udhëzimeve të dhëna nga MASR, në zbatim të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë, si edhe me Udhëzimet përkatëse të MASR.

Secili anëtar i personelit akademik ka përgjegjësinë të adaptojë silabusin e përgatitur nga departamenti, që përfshin të gjitha detajet në lidhje me lëndën. Pedagogu mund të propozojë rishikime të mundshme të silabusit, dhe hapjen e lëndëve të reja.

Format e kontrollit të njohurive

Pedagogu i lëndës vendosë të administrojë provimin me shkrim, me gojë, ose në formë projekti. Kriteret dhe format e vlerësimit janë të përcaktuara qartë në silabusin e secilës lëndë. Studenti mund të kundërshtojë rezultatin e provimit duke plotësuar dhe dorëzuar një kërkesë për apelim note në Zyrën e Regjistrimeve brenda pesë ditësh nga shpallja e notës. Apeli vlerësohet paraprakisht nga pedagogu i lëndës se mos ka gabim të rastit. Dekanati merr vendimin në lidhje me apelin, duke u bazuar në propozimin e këshillit të Departamentit të lëndës në fjalë. Vlerësimi i studentit bazohet në sistemin amerikan dhe ECTS, i llogaritur sipas nenit 26 të Rregullores për Programin e Studimeve të Ciklit të Dytë në Universitetin "EPOKA". Vlerësimi sasior i punës së studentit bëhet me nota-shkronja sipas tabelës më poshtë

Nota	Koeficienti	*Pikë	Nota sipas sistemit shqiptar	Përshkrimi
AA	4.00	90-100	10	SHKËLQYER
BA	3.50	85-89	9	SHKËLQYER
BB	3.00	80-84	8	I SUKSESSHËM
CB	2.50	75-79	8	I SUKSESSHËM
CC	2.00	70-74	7	I SUKSESSHËM
DC	1.50	65-69	6	NË PROVË
DD	1.00	60-64	5	NË PROVË
FD	0.50	50-59	4	JOKALUES
FF	0.00	00-49	0	JOKALUES
NA	0.00	00-00	0	JOKALUES

*nga 100 pikë

Nota të cilat nuk llogariten në mesatare janë si më poshtë:

I- Me mangësi, S- Mjaftueshëm, T- Transferuar U- Pamjaftueshëm P- Në vijim
EX- Përfunduar nga detyrimi NI- Nuk ka marrë pjesë

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësishë etj

Në fund të semestrit, studentët plotësojnë një anketë *online* përmes EIS për lëndën dhe pedagogun. Departamenti analizon rezultatet e anketës studentore për qëllime përmirësimi të silabusit dhe personelit akademik. Gjithashtu studentët aktivizohen në punët e departamentit si në tabelën në vijim

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	16
Për projekte shkencore në rang Departamenti	92
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	-
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjerë	-

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u takua edhe me disa nga studentët që ndjekin këtë program studimi. Interesimi i tyre për të ndjekur këtë institucion në përgjithësi kishte ardhur nga emri i mirë i Universitetit, nga rekomandimet e të afërmeve apo edhe shokëve të cilët kanë ndjekur këtë Universitet në degë të tjera të ofruara prej tij, por edhe nga marketingu që realizohet në cdo fund të vitit akademik nga përfaqësues të këtij institucioni. Studentët që janë të interesuar dhe plotësojnë kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara nga universiteti, mund të aplikojnë duke plotësuar formularin e aplikimit *online* që gjendet në faqen zyrtare të internetit të Universitetit. Njëkohësisht, duhet të dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm pranë Zyrës së Pranimeve. Si hap i fundit, dosja e secilit student i dorëzohet departamentit ku komisioni shkencor vendos për pranimin apo refuzimin e aplikimit, bazuar në kriteret e paracaktuara.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Kandidati aplikon duke plotësuar formularin e aplikimit. - Dorëzon dokumentet te Zyra e Pranimeve. - Dosja e aplikantit i dërgohet departamentit përkatës. - Komisioni shkencor miraton ose refuzon aplikimin, bazuar në dosje dhe kriteret e paracaktuara të departamentit. - Zyra e Pranimeve ia komunikon vendimin aplikantit. - Pas gjithë këtyre procedurave, dosja e aplikantit dorëzohet te Zyra e Regjistrimit. - Aplikantët që vendosin të regjistrohen, duhet të paguajnë tarifën e shkollimit (me dy këste) dhe të nënshkruajnë kontratën me Zyrën e Regjistrimeve.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Studentët në hyrje kanë kriteret rigorozet dhe sipas standarteve por vihet re se gati 50% e tyre nuk e përfundojnë masterin në kohëzgjatjen minimale. Numri i studentëve është i kufizuar që është element pozitiv në mësimdhënie dhe një numër i kosiderueshëm i tyre janë punësuar në profesion mbas përfundimit të studimeve
Shiko Tabelën 11 në aneks:

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Nr i kufizuar rregjistrimesh që është element pozitiv në mësimdhënie por nga ana tjetër nota mesatare e të diplomuarve është relativisht e ulët lartë që është tregues i cilësisë së dobët të tyre.

Shiko Tabelën 11 në aneks:

Studentë të diplomuar në vitin e fundit janë 3 studentë

Shiko Tabelën 13/1 në aneks:

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Ka fare pak lëvizje të studentëve për të mos thënë gati e papërfillshme

Shiko Tabelën 11 në aneks:

Të dhëna për punësimin e studentëve

Një numër i kosideruesëm i tyre janë punësuar në profesion mbas përfundimit të studimeve

Për më shumë informacion shiko Tabelën 13/1 në Aneks:

Numri total të diplomuarve

Per tre vitet e fundit akademike, numri i të diplomuarve është 17 studentë.

Për më shumë informacion shiko Tabelën 13/1 në Aneks:

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Per tre vitet e fundit akademike, numri i të punësuarve në përputhje me diplomën është 11 veta.

Për më shumë informacion shiko Tabelën 13/1 në Aneks:

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Logjikisht del si diferencë nga tabela e të punësuarve në profesion. Referuar të dhenave numri i të punësuarve jo në përputhje me diplomën është 2 dhe kjo është një e dhënë për studentët që kanë mbaruar në vitin 2015-2016. Për vitin 2016-2017 dhe 2014-2015 kjo shifër është 0.

Për më shumë informacion shiko Tabelën 13/1 në Aneks:

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Bazuar në Rregulloren e Programeve të Studimeve të Ciklit të Dytë, studentët që ndjekin Masterin Profesional në Financë-Bankë duhet të kenë të paktën diplomën <i>Bachelor</i> financë ose në një fushë të përfaqshme dhe të kenë grumbulluar 180 kredite ECTS. Aktualisht të regjistruar për herë të parë në vitin akademik 2017-2018 janë 18 studentë.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Gjuha e studimit është në gjuhën angleze. Studentët na komunikuna se duhet të kenë njohuri të mjaftueshme të kësaj gjuhe për tu regjistruar në këtë Master. Kryesisht studentët janë ata që kanë mbaruar studimet Bsc po në këtë Institucion dhe njohuritë e tyre në gjuhën angleze janë të larta.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimi të përcaktuara nga institucioni;	Të gjithë studentët që ndjekin Masterin Profesional në Financë-Bankë pranohen në bazë të kriterëve të pranimi të përcaktuara nga institucioni, në pajtim me Ligjin për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë dhe me miratimin e komisionit shkencor të departamentit të Financës.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve	

<p>“Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>Bazuar në Rregulloren e Programeve të Studimeve të Ciklit të Dytë të Universitetit "EPOKA", studentët e regjistruar në këtë Master Profesional duhet të dorëzojnë certifikatë të zotërimit të anglishtes minimalisht e nivelit B2, e cila njihet ndërkombëtarisht dhe njëkohësisht nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Ligji nr. 80/2015, datë 25.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", studentët që kanë përfunduar një cikël studimesh në gjuhën angleze, nuk duhet të dorëzojnë certifikatë të anglishtes.</p> <p>Në fund të çdo viti akademik, Senati vlerëson ndikimin e politikave aktuale të pranimit për studentët në programet e studimeve të këtij masteri. Kur është e nevojshme, miraton ndryshime specifike në kriteret e përcaktuara për pranimin e studentëve, me qëllimin përmirësimin e cilësisë së studentëve që vijnë, me synim përfundimin me sukses të çdo programi studimesh nga studentët e pranuar.</p>
--	--

Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.

<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit gjatë studimeve të tyre dhe pas diplomimit, përmes komunikimit të vazhdueshëm me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të të Diplomuarve (http://cpao.epoka.edu.al/). Panairi i Karrierës i organizuar çdo vit ku marrin pjesë dhjetëra kompani. Është një tjetër mundësi e mirë për studentët që të aplikojnë direkt për një vend pune, ose që të japin detajet e kontaktit dhe të dorëzojnë CV-të e tyre pranë këtyre kompanive për ato pozicione pune që iu interesojnë.</p> <p>Zyra e Pranimit informon studentët e interesuar në lidhje me akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve specifike. Ata informohen edhe për njohjen dhe vlefshmërinë e diplomës që lëshon institucioni në vend dhe jashtë vendit. Ndërkohë, kur programet janë në proces akreditimi, departamenti organizon takime të posaçme dhe sesione informimi, me qëllim informimin e studentëve të regjistruar për këtë proces dhe, kur është e nevojshme, për t'i bërë pjesë të këtij procesi.</p> <p>(http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html).</p> <p>Studentëve iu ofrohet këshillim karriere dhe punësimi pas diplomimit, përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe të të Diplomuarve, që funksionon nën Dekanin e Studentëve.</p>
---	--

Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të</p>	<p>Universiteti "EPOKA" disponon statistikat vjetore për numrin e të diplomuarve nga programi i studimeve Master Profesional në Financë-Bankë. Gjithashtu, kryen vlerësime në funksion të rezultateve dhe performancës së diplomimit në tregun e punës (<i>Rezultatet e Diplomimit në Tregun e Punës: 10 vjet me Arritje</i>, ISBN 978-9928-135-24-7; Epoka University, Tirana. Jan 2018).</p>
---	--

<p>ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Universiteti "EPOKA", përmes Zyrës së Regjistrimit dhe Koordinatorit të Departamentit mban statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në Masterin Profesional Financë-Bankë, largimet nga programi, apo mospërfundimet me sukses të vitit akademik. Njëkohësisht, Universiteti "EPOKA" mban dhe ndjek statistikat e studentëve të vet në bazën e të dhënave elektronike EIS (http://eis.epoka.edu.al/studentdata/).</p> <p>Zyra e Regjistrimit ka të gjitha të dhënat e mundshme për performancën akademike të studentëve nga pranimi deri në diplomim. Sistemi Interaktiv Epoka (EIS) është një sistem ku njësitë e ndryshme të universitetit si Zyra e Regjistrimit dhe Këshilltarët Akademikë mund të kenë informacion në kohë reale dhe të ndjekin performancën e studentëve përgjatë procesit mësimor dhe të marrin të gjitha të dhënat e nevojshme për përparimin akademik të studentëve. (http://eis.epoka.edu.al/studentdata/)</p>
<p>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Universiteti "EPOKA" mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programit Master Profesional në Financë Bankë si dhe për vendet e punësimit të tyre. (http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-office-1457-1491.html)</p> <p>Zyra e Planifikimit të Karrierës dhe Të Diplomuar mirëmban një bazë të dhënash me studentët që vazhdojnë studimet në cikle të tjera studimesh. Kjo siguron gjurmim të saktë të studentëve të vazhdojnë studimet e Doktoratës apo cikle të tjera studimesh në Shqipëri apo jashtë vendit. (http://cpao.epoka.edu.al/home-alumni-office-1457-1491.html)</p>
<p>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p>	<p>Gjatë javës orientuese, studentët informohen rreth programeve të studimeve, organizimin e tyre, afatet për përfundimin dhe statusin e akreditimit të programit. Shpallja bëhet në bazë njësie, përmes njoftimeve në faqen e internetit të Universitetit "EPOKA", ku është linku që i çon studentët te faqja e internetit e ASCAL-it. (http://baf.epoka.edu.al/home-m-sc-in-banking-and-finance-1761-227.html);</p> <p>http://aeqi.epoka.edu.al/home-external-evaluation-reports-1479-1481.html)</p>
<p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në fund të programit. Rezultatet e vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm gjenden në faqen e internetit të Këshillit të Vlerësimit Akademik dhe Përmirësimit të Cilësisë në faqen zyrtare (http://aeqi.epoka.edu.al/home.html).</p> <p>Në lidhje me vlerësimin akademik, studentët janë në komunikim të vazhdueshëm me pedagogët dhe këshilltarët akademikë. Ata mund të aksesojnë informacionin për performancën akademike të tyre</p>

	<p>përmes Sistemit Interaktiv Epoka duke përdorur llogarinë personale.</p> <p>Përgjegjësi i departamentit i diskuton rezultatet e këtyre vlerësimeve me studentët.</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Studentët mbikëqyren vazhdimisht nga këshilltarët akademikë që iu caktohen në fillim të programit të studimeve, në funksion të performancës dhe progresit akademik të tyre. Ata asistojnë dhe këshillojnë studentët gjatë përzgjedhjes së lëndës dhe i ndihmojnë të adresojnë çështje të ndryshme që mund të dalin gjatë procesit mësimor. Lista e këshilltarëve akademikë për Departamentin e Financë-Bankës është në faqen e internetit të Departamentit. (http://baf.epoka.edu.al/home-academic-advisors-235-1766.html).</p> <p>Institucioni, përmes Zyrës së Planifikimit të Karrierës nën Dekanin e Studentëve krijon mundësi për praktika profesionale në institucione dhe kompani të ndryshme, me të cilat ka marrëveshje dypalëshe. Studentët e interesuar mund të bëhen pjesë e praktikave profesionale duke aplikuar pranë Zyrës së Planifikimit të Karrierës dhe të Të Diplomuarve.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Studentët që ndjekin Masterin Profesional Financë-Bankë pranohen sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga institucioni. Ata zotërojnë diplomë <i>Bachelor</i> dhe kanë akumuluar 180 kredite ECTS 2. Institucioni informon studentët për statusin e institucionit, programet e studimeve që ofron dhe politikat e punësimit 3. Universiteti "EPOKA" disponon statistikat vjetore me numrin e të diplomuarve nga ky program i studimeve. Zyra e Regjistrimit, Zyra e Pranimit dhe Koordinatorin e Departamentit disponojnë statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në Masterin Profesional në Financë-Bankë, tërheqjet nga ky program studimesh, si edhe pezullimet apo ndërprerjet e procesit të studimeve, si edhe statistikat e studentëve nuk përfundojnë me sukses vitin akademik 4. Studentëve u jepet informacion për mundësitë e punësimit gjatë studimeve të tyre dhe pas diplomimit, përmes komunikimit të vazhdueshëm me Zyrën e Planifikimit të Karrierës dhe të Të Diplomuarve. <p>Bazuar sa më sipër vlerësojmë se Standardet përmbushen.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

GVJ thekson se: Universiteti "EPOKA" ka një politikë të caktuar të kërkimit shkencor në përputhje me Planin e vet Strategjik në kuadrin e Rregullores së Kërkimit Shkencor të institucionit, nën Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe Projekteve.

Universiteti "EPOKA" ka Qendrën për Studime Evropiane (CES) që i shërben edhe këtij Masteri Qendra organizon forume, konferenca dhe aktivitete të ndryshme për t'iu mundësuar ndërveprimin e duhur personelit, studentëve dhe individëve të interesuar në qendër, në lidhje me çështjet aktuale të Bashkimit Evropian (<http://ces.epoka.edu.al/>).

Universiteti inkurajon të gjithë anëtarët e personelit akademik të jenë aktivë në fushën e kërkimit, duke iu ofruar mbështetje të vogla financiare si në numër edhe në vlerë. Në fund të çdo viti akademik, të gjitha botimet shkencore të botuara nga personeli akademik vlerësohen nga një juri e veçantë në bazë të kriterëve të përcaktuara në "Rregulloren për Nxitjen e Publikimeve Shkencore" të Universitetit "EPOKA". Çdo vit, Rektorati vendos shpërblim për çdo pikë të fituar dhe në bazë të pikëve të mbledhura, secili anëtar i personelit akademik përfiton shpërblimin e duhur. Universiteti "EPOKA" ofron mbështetje financiare edhe për pjesëmarrjen e personelit akademik në konferenca dhe aktivitete shkencore, të organizuara brenda dhe jashtë vendit, sipas të njëjtës rregullore.

Nga ana tjetër, Universiteti "EPOKA" mbështet financiarisht projektet e brendshme të personelit akademik nën Udhëzimet e Përbashkëta për Dorëzimin e Projekt-propozimeve Shkencore dhe tezat e Doktoratës të programeve të studimeve PhD, sipas të njëjtës rregullore. Universiteti "EPOKA" organizon ose ri-organizon konferenca dhe aktivitete shkencore (<http://conf.epoka.edu.al/>).

Për të promovuar politikën e kërkimit shkencor dhe kontributin në fushën akademike, Universiteti "EPOKA" ka dy revista akademike që janë: Revista e Kërkimit Social Evropian (<http://ejs.epoka.edu.al/>) dhe Revista Ndërkombëtare e Ekonomiksit dhe Statistikës së Aplikuara, në bashkëpunim me Shoqatën e Ekonomistëve të Shqipërisë (<http://esa.org.al/journal/>).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor (Ploteso Tabelat ne aneks)

Fushat Kërkimore dhe Grupet përcaktohen me bazë departamenti në programin Financë-Bankë si më poshtë: (<http://baf.epoka.edu.al/home-research-groups-236-2216.html>). Ka 4 grupe kërkimore me 4-5 anëtar secili. Aktualisht janë dhënë 4 projekte me financim të brendshëm për 2 nga studentët doktoraturë me vlerë 1 deri 2 mijë euro secili. Gjithashtu ka 2 projekte Erasmus + në Universitet dhe 1 Horizon 2020 por janë projekte ngritje kapacitetesh dhe jo projekte të mirëfillta kërkimore shkencore.

Nisur nga lidhja ndërmjet kërkimit shkencor dhe mësimdhënies, studentët inkurajohen të ndërmarrin kërkim shkencor. Gjatë viteve akademike, studentët e departamentit të Financë-Bankë kanë marrë pjesë në konferenca dhe publikime në revista shkencore:

Personeli akademik i departamentit inkurajohet të bëjë punë kërkimore dhe shkencore në përputhje me aftësitë profesionale dhe përgjegjësitë e tyre. Secili anëtar i personelit akademik vlerësohet një herë në vit për kontributin që jep me aktivitet shkencor. Gjatë viteve akademike, një pjesë e mirë e personelit akademik kanë marrë pjesë në konferenca dhe aktivitete të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.

Departamenti i Financë-Bankës dhe Departamenti i Ekonomiksit të Universitetit "EPOKA" publikojnë Revistën Shkencore Ndërkombëtare të Statistikës së Aplikuara dhe Informacion për revistën gjenden në linkun <http://esa.org.al/>. Bordi redaksional i IJASE përbëhet nga akademikë në fushën e ekonomiksit dhe financave, statistikave dhe ekonometrisë.

Universiteti "EPOKA" në bashkëpunim me Institutin e Statistikave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatën e Ekonomistëve të Shqipërisë organizoi Konferencën e parë Ndërkombëtare të Statistikës së Aplikuara dhe Ekonometrisë më 27-28 prill 2017, në Tiranë. Qëllimi i konferencës ishte mbledhja e studjuesve që të ndajnë dhe të shkëmbejnë përvojat dhe rezultatet kërkimore të tyre në lidhje me Statistikat e Aplikuara dhe Ekonometrinë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	

<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik, GVJ ju komunikua se personeli akademik publikon artikuj dhe materiale shkencore në disiplinën përkatëse. (http://feas.epoka.edu.al/home-journalarticles-442-558.html)</p> <p>Personeli akademik përmes pjesëmarrjes në aktivitete dhe organizimit të konferencave shkencore dhe ëorkshopeve të ndryshme, jep kontributin e vet në studimet e aplikuara dhe të sektorëve të ekonomisë.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Bazuar edhe në dosjet e personelit akademik pranë së Burimeve Njerëzore, personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studime universitare në atë gjuhë ose zotëron një certifikatë për njohje të avancuar të saj.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë të paktën një semestër.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtjshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtjshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Institucioni ka në fokus dhe organizon programe specifike për kualifikimin e mëtjshëm të personelit akademik dhe mësimdhënës, si trajnime të brendshme, ëorkshope, etj. (http://aeqi.epoka.edu.al/catactivities1411.html)</p> <p>Universiteti "EPOKA" i ofron personelit akademik dhe shkencor mundësinë e kualifikimit të mëtjshëm jashtë vendit ose në Shqipëri, duke i mbështetur financiarisht gjatë këtyre programeve. Gjithashtu i siguron mundësi personelit akademik të rritë kualifikimet kërkimore dhe mësimdhënëse në kuadrin e marrëveshjeve e mobilitetit të personelit nën Erasmus+ me universitetet e vendeve evropiane (http://projects.epoka.edu.al/home-ongoingerasmus-projects-1536-1578.html; http://iro.epoka.edu.al/home-erasmusprogramme-1151-1638.html).</p>
<p>Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.</p>	<p>Në departament dhe në fakultet ka një bazë të dhënash të plotë për punimet kërkimore, publikimet dhe pjesëmarrjen në konferenca brenda dhe jashtë vendit në fund të çdo viti akademik. (http://dspace.epoka.edu.al/; http://feas.epoka.edu.al/home-journalarticles-442-558.html)</p> <p>Universiteti mbështet pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhime në projekte kërkimore, si dhe shpërblen performancën akademike me tregues transparentë me bazë publikimi (tekste, monografi, libra, artikuj ose konferenca). (http://epoka.edu.al/mat/directives/03.pdf; http://dspace.epoka.edu.al/; http://feas.epoka.edu.al/home-journalarticles-442-558.html)</p> <p>Zyra e Kërkimit dhe Projekteve bashkë me Zyrën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare mban një bazë të dhënash për projektet ku merr pjesë personeli akademik. Universiteti "EPOKA" ka Repositor DSpace që është shërbim dixhital që mbledh, ruan dhe shpërndan materiale dixhitale. (http://dspace.epoka.edu.al/)</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>1. Departamenti angazhohet në kualifikimin e personelit të vet dhe disponon një bazë të dhënash të plotë me punimet kërkimore, publikimet dhe pjesëmarrjet në konferenca, në përputhje me nevojat e personelit akademik</p>	

2.institucioni mbështet financiarisht pjesëmarrjen në aktivitete shkencore dhe angazhimin në projekte kërkimore, si edhe shpërblen performancën akademike me tregues transparentë me bazë publikimi (tekste, monografi, libra, artikuj ose konferenca) brenda ose jashtë vendit

Bazuar sa më sipër vlerësojmë se Standardet përmbushen

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

Strategjia institucionale e Universitetit "EPOKA" është ndërtuar mbi trekëndëshin "Mësimdhënie, Kërkim Shkencor dhe Kontribut ndaj Shoqërisë", në përputhje me Planin Strategjik. Universiteti "EPOKA" ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare dhe kombëtare. Ndër partnerët më aktiv janë: Këshilli i Investimeve të Shqipërisë, Shoqata Shqiptaro-Amerikane Biznesit, Bashkia e Tiranës, Këshilli Britanik i Shqipërisë, Qendra Yunus, Dhaka etj. Universiteti "EPOKA" është një universitet aktiv në Shqipëri me programet e shkëmbimit të studentëve dhe personelit me universitete të huaja (<http://iro.epoka.edu.al/home-erasmus-programme-1151-1638.html>).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar

Referuar të dheanve në RVB por edhe materialeve të paraqitura në dosdjen e vetvleresimit, si dhe mbështetur edhe në takimet e realizuar në Institucion, konstatojmë se:

- Universiteti "EPOKA" bashkëpunon me universitete në BE, në kuadrin e Programit Erasmus+, me projekte që synojnë të mbështesin nismat në fushën e Arsimit, Formimit Profesional, Rinisë dhe Sporteve, si dhe shkëmbimin e stafit dhe të studentëve. Universiteti "EPOKA" është aktualisht institucion partner në tre projekte të Ndërtimit të Kapaciteteve Erasmus + KA 2 dhe në një projekt Horizon 2020 (<http://projects.epoka.edu.al/cat-about-us-1167.html>). Universiteti "EPOKA" është edhe anëtar i asociuar i Shoqatës së Universiteteve Evropiane (EUA), nënshkruese e Magna Charta Universitatum, Parimeve të Menaxhimit të Përgjegjshëm të Arsimit, një nismë e Kombeve të Bashkuara dhe partner i Qendra Yunus, Dhaka.
- Departamenti i kushton rëndësi promovimit të personelit akademik, publikimit në revista ndërkombëtare dhe me peer review, si edhe projekteve. Kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në projekte e personelit akademik inkurajohet dhe shpërblehet. Një pjesë e buxhetit i alokohet pjesëmarrjes në konferenca, me qëllim rritjen e aftësive kërkimore të tyre. Me vendim të Rektoratit, bazuar në cilësinë e artikullit apo punimit, studiuesit i jepet mbështetje financiare.
- Zyra e Kërkimit dhe Projekteve (Këshilli i Koordinimit të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe Zyra e Koordinimit dhe Këshillimit të Projekteve) është njësia qën synon të zhvillojë më tej infrastrukturën kërkimore. Drejtuesit e Universitetit mendojnë të fokusojnë buxhetin kërkimor për projekte kërkimore të vogla.

Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë (plotëso te dhenat ne aneks)

Departamenti mban marrëdhënie të mira me subjektet industriale vendase dhe rajonale. qëllim fillimin dhe mbështetjen e projekteve ndërkombëtare, me ekipe të përbërë nga institucione të ndryshme, duke prodhuar dhe shpërblyer projektet ndër disiplina të ndryshme. Universiteti "EPOKA" i kushton shumë rëndësi marrëdhënieve me institucionet publike dhe organizatat në vend.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.	
<p>Kriteri 1 Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve "Master Profesional", institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuese;</p> <p>Kriteri 2 Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve "Master i Shkencave" ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimin e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.</p>	<p>Programi i studimeve Master Profesional në Financë Bankë tenton të ofroj dijet që nevojiten në sektorin publik dhe privat, përmes bashkëpunimit me ekspertë nga industria dhe profesionistë ndërkombëtarë me aftësi të larta. Ekzistojnë marrdhënie të mira me institucione publike dhe private për të realizuar këtë qëllim.</p>
Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.	
